



	<b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova – Republic of Kosovo  <b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Prishtina – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-104362/24 dt. 08.08.2024, të kërkuarit/ pronarëve “ERVB” shpk., me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me investitor “Marigona Hill” shpk me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me pronarëve Valton Bilalli dhe Rasim Mrlaku që të gjithë nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për 9 (nëntë), ndërtesa të Tipit Terracier “T1-T9”, të ndërtuara në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishem për Tërësinë urbane “B”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Lindje” në Prishtinë, në rr. “Ura Vajgurore”, dhe “Thoma Kacori”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 01.10.2024, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuarit/ pronarëve “ERVB” shpk., me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me investitor “Marigona Hill” shpk me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me pronarëve Valton Bilalli dhe Rasim Mrlaku që të gjithë nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-104362/24 dt. 08.08.2024, përdorimi i 9 (nëntë) ndërtesave të Tipit Terracier “T1-T9”, me etazhitet B+S+P+2, e ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit” 05 Nr. 351/02-310321/19 dt. 14.04.2020, të lëshuar nga kjo drejtori, në parcelat kadastrale nr. 1239-4 dhe 1239-6, ZK Hajvali, në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishem për Tërësinë urbane “B”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Lindje” në Prishtinë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Ura Vajgurore” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 41, 43, 45, 47, 51, 53, 55, 57, 61, 63, 65, dhe 67, në Prishtinë, dhe në rrugën “Thoma Kacori” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 44, 46, 54, 56, 64, dhe 66, në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkuarit/ pronaret “ERVB” shpk., me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me investitor “Marigona Hill” shpk me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me pronarëve

Valton Bilalli dhe Rasim Mrlaku që të gjithë nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-104362/24 dt. 08.08.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për 9 (nëntë) ndërtesa "T1-T9", me etazhitet B+P+S+2, e ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues të Hollësisëm për Tërësinë urbane "B", të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Lindje" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parceles kadastrale nr. 1239-4 dhe 1239-6, ZK Hajvali, ndërtuar sipas "Vendimit për Lejimin e Ndërtimit" 05 Nr. 351/02-310321/19 dt. 14.04.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-205274/23 dt. 19.07.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuarit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Alban Fazliu/Gezim Baholli; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Burhan Rexhipi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Kreshnik Maloku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Dëshira Murturi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Arber Bajraktari; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Arban Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Alban Grajçevci me nr. të licensës 75 dhe kompania e licensur gjeodete "Geoservice Engineering" shpk me nr. të licensës 74 dhe;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, dhe instalimet e makineris, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht 9 (nëntë), ndërtesa të Tipit Terracier "T1-T9", mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që 9 (nëntë), ndërtesat e Tipit Terracier "T1-T9", mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për 9 (nëntë), ndërtesa të Tipit Terracier "T1-T9".



Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-104362/24 DT. 01.10.2024**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi



